



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 18.7.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 18 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Ai shqyrtohet bazuar në nenin 121 të Kushtetutës dhe sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të paraqitur dhe për të dhënë sqarime mbi projektligjin, Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Zëvendësministri i Financave, si dhe përfaqësues nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar.

Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji parashikon që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë të marrë nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim një hua në shumën 50 milionë USD, e cila do të përdoret për financimin e projektit të konektivitetit të rrugëve rajonale e lokale.

Ky projekt ka qëllim të përmirësojë aksesin drejt qendrave të përzgjedhura agrobujqësore dhe të turizmit, si dhe të forcojë kapacitetet e bashkive të këtyre qendrave për menaxhimin e aseteve rrugore.

Projekti është i ndarë në tri pjesë, të cilat kanë objekt:

- Rehabilitimin e rrugëve rajonale e lokale dhe përmirësimin e sigurisë rrugore në zonat e përzgjedhura;
- Ngritjen e kapaciteteve të bashkive të përzgjedhura për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore dhe për të zbatuar programet e zhvillimit rural;
- Mbështetjen për menaxhimin e projektit, ku vend të rëndësishëm zë mbajtja e një sistemi të informacionit gjeografik dhe përdorimi i një databaze për prioritizimin e rrugëve rajonale e lokale.

Zbatimi i këtij projekti pritet të sjellë:

- Rehabilitimin e rrugëve rajonale e lokale, duke përmirësuar cilësinë dhe rritur sigurinë në rrjetin rrugor lidhës në zonat e rurale e turistike;
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë së rrjetit rrugor;
- Forcimin e kapaciteteve të FZSHS dhe të bashkive në zonat e projektit për të menaxhuar projektet e ndërtimit të aseteve rrugore.

Termat financiarë të huasë janë:

- | | |
|------------------------|---|
| - Interesi | bazuar në normën e referencës + marzh të pandryshueshëm; |
| - Tarifa e parapagimit | 0.25 për qind e shumës së huasë; |
| - Tarifa e angazhimit | 0.25 për qind e shumës së padisbursuar të huasë; |
| - Maturimi | 29.5 vjet, duke përfshirë periudhën prej 6 vjetësh pa pagesë
principali. |

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve është data 31 dhjetor 2022. Projekti i parashikuar në këtë marrëveshje është pjesë e PBA 2018-2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Gjatë diskutimeve z. Haxhinasto shprehu mendimin që të unifikohet mënyra e planifikimit të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, si një sistem financiar që të grumbullojë të gjitha kontributet.

Vlerësimi për projektligjin.

Komisioni është i mendimit se marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj është mjaft e rëndësishme, pasi do të sjellë përmirësimin e rrjetit rrugor lidhës në zonat rurale dhe ato me potencial turistik, duke ndihmuar në lehtësimin e lëvizjes së popullsisë dhe të qarkullimit të mallrave apo produkteve bujqësore e turistike. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe të turizmit në vendin tonë, të cilat janë edhe fushat kryesore prioritare të programit qeveritar dhe të strategjive afatmesme të zhvillimit të vendit.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash.

RELATORI

Arben PËLLUMBI

KRYETARI

Erion BRAÇE